



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.169/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesat e Institutit Demokratik I Kosovës-KDI, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, dega në Gjilan, për shkak të vendosjes së posterave në hapësira publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

HEDHEN si të pa rregullta ankesat e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, me numër të ankesave Anr.169, Anr.170 dhe Anr.171 të datës 08.06.2017 të parashtuara kundër Koalicionit LDK-AKR-dega në Gjilan

A r s y e t i m

Me datën 08.06.2017, PZAP-i ka pranuar tre ankesa nga Institutit Demokratik i Kosovës-KDI, në të cilat pretendon se me datën 07.06.2017 në rrugën “Idriz Seferi” dhe në rrugën “Muharrem Gashi” në qytetin e Gjilanit, aktivistët e tyre kanë vërejtur se në shtylla publike dhe në drunjë ishin të vendosur posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e Koalicionit LDK-AKR.

Me këtë rast parashtuesi i ankesave thekson se nga ana e Koalicioni LDK-AKR, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në momentin e vendosjes së posterave në shtylla publike përkatësisht në drunjë të qytetit.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartëcekura dhe i trajton si një ankesë të evidentuar me Anr 169/2017 për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për tre ankesat vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesave gjeti se:

Ankesat janë të pa rregullta

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndëve shihet qartë se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e Koalicionit LDK-AKR siç janë pretenduar

në ankesa nuk qëndrojnë sepse në këto fotografi të ofruara nga KDI shifen posterat e vendosur nga kandidatët për deputet nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA

Duke u nisur nga gjendja e faktike, Paneli vlerësoi se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit LDK-AKR, nuk është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që vendosja e posterave në shtylla elektrike dhe drunjë në qytetin e Gjilanit nuk është bërë nga ana e kandidatëve për deputet nga radhët e koalicionit në fjalë.

Paneli në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.169/2017 më datën 09.06.2017.



Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

A handwritten signature in blue ink, which appears to be "Rafet Haxhaj", written over the printed name.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*